



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 949 Prot.

Tiranë, më 27. 7 2018

VENDIM Nr. 168, datë 18.07.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 7, datë 18.07.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC LJUSA" në përroin e Zallit të Madh, degë e përroit të Lusës, lumi Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër*- subjekti "DIEZELA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC LJUSA" në përroin e Zallit të Madh, degë e përroit të Lusës, lumi Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër*- subjekti "DIEZELA" sh.p.k., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj.
2. Subjekti "DIEZELA" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "HEC LJUSA" në përroin e Zallit të Madh, degë e përroit të Lusës, lumi Mat, Bashkia Mat, Qarku Dibër", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrisë Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al